

Nr. _____ prot

Tiranë, _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Marrje me qera e automjeteve për shoqërinë “OSHIS” sha”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
60171000-7**

FONDI LIMIT TOTAL/VLERA E PRITSHME E KONTRATËS: 40,837,964 (dyzet milion e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 435,372.75 (katërqind e tridhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 9.7.2026 është 93.80 Lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “**Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit**” sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, **sipas Shtojcës 4;**

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, **sipas shtojcës 9;**

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i

vetëdeklarimit”, nenit 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Neni 83 “Sigurimi i ofertës” i LPP-së në të cilën është e përcaktuar se: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, i LPP-së përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në Shtojcën 8, pika 1 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 “Kriteret e kualifikimit/pjesëmarrjes” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet se: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe Nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së përllogaritur të marrëveshjes kuadër. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 40, pika 4 të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, të vlefshme, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit, ose ekuivalent.

Çertifikata e mësipërme duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të kryer shërbime dhe që janë vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që shërbimi të kryhet me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencën e kategorisë VII.3.B.1“Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, është vendosur në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 40, pika 4, shkronja “ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL), dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, si dhe në zbatim të

Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, të cilat i japin të drejtë autoritetit kontraktor të kërkojë nga operatorët ekonomikë dëshmi mbi kapacitetin teknik dhe profesional, kur këto janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet drejtpërdrejt me automjetet dhe garantimin e funksionalitetit të tyre gjatë zbatimit të kontratës, paraqitja e kësaj licence shërben për të provuar se operatori ekonomik ushtron ligjërisht veprimtarinë e autoriparimit dhe disponon kapacitetin e nevojshëm teknik e profesional për realizimin e shërbimeve përkatëse.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër pajisjen e mjetit me siguracionin e nevojshëm, për të gjithë periudhën e qirasë së plotë operacionale.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se do të mbulojë të gjitha detyrimet në lidhje me institucionet përkatëse (taksa rrugore/qarkullimi të vitit përkatës /etj).

Argumentim për kriteret 2.3.4 dhe 2.3.5: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 pika 3 dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Këto kritere janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi synojnë të garantojnë që automjetet do të jenë të disponueshme, funksionale dhe të ligjshme për përdorim gjatë gjithë periudhës së kontratës. Mosplotësimi i këtyre detyrimeve do të çënonte realizimin normal të kontratës, do të rriste rrezikun e ndërprerjes së shërbimit dhe do të ndikonte negativisht në përmbushjen e nevojave të Autoritetit Kontraktor.*

Gjithashtu, këto kërkesa janë proporcionale me objektin dhe vlerën e kontratës, nuk kufizojnë konkurrencën dhe nuk vendosin detyrime shtesë përtej atyre që operatorët ekonomikë kanë sipas legjislacionit në fuqi. Çdo operator ekonomik që ushtron aktivitet në fushën e dhënies së automjeteve me qira duhet të sigurojë që automjetet e ofruara të jenë të pajisura me siguracionet e nevojshme dhe të kenë të shlyera të gjitha detyrimet ligjore për qarkullimin e tyre. Për këtë arsye, kerkimi i deklaratave përkatëse konsiderohet një mjet i përshtatshëm dhe proporcional për të garantuar zbatimin korrekt të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skedën teknike/broshuren/katalogun teknik/fragmente të tyre, me qëllim krahasimin e specifikimeve të mjeteve të ofruara në përputhje me specifikimet teknike.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 pika 6, germa b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri është e nevojshme për të garantuar që automjetet e ofruara përmbushin kërkesat minimale teknike dhe funksionale të Autoritetit Kontraktor, duke shmangur pranimin e automjeteve që nuk plotësojnë parametrat e kërkuar. Në mungesë të këtij dokumentacioni, Autoriteti Kontraktor nuk do të kishte mundësi të verifikonte në mënyrë objektive*

përputhshmërinë e ofertës me specifikimet teknike, duke rrezikuar përzgjedhjen e automjeteve që nuk i përgjigjen nevojave të kontratës. Kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcionale dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi katalogët, broshurat dhe skedat teknike janë dokumente standarde që disponohen nga prodhuesit ose distributorët e autorizuar të automjeteve dhe mund të sigurohen nga çdo operator ekonomik që ofron automjete të përshtatshme për realizimin e kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) ambient/servis për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që provon disponimin e ambientit/servisit, si certifikatë pronësie/ kontratë qiraje/ kontratë huapërdorjeje, të vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.

Argumentimi: *Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) ambient/servis për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, si dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës provues mbi pronësinë ose disponimin e ligjshëm të tij, është vendosur në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 40, pika 4, shkronja “ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor synon të verifikojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin teknik dhe infrastrukturën e nevojshme për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, në mënyrë të vazhdueshme dhe brenda standardeve të kërkuara. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet drejtpërdrejt me mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve gjatë gjithë periudhës së kontratës, disponimi i një ambienti/servisi funksional dhe të ligjshëm është i domosdoshëm për garantimin e ekzekutimit korrekt të saj. Kjo kërkesë është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për konkurrencën.*

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) karrotrec, të gatshëm për ofrimin e shërbimit gjatë 24 (njëzet e katër) orëve, për transportin e automjeteve në rast defekti.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion provues për disponimin e karrotrecit, si leje qarkullimi, certifikatë pronësie/ kontratë qiraje/ kontratë huapërdorjeje ose çdo dokument tjetër që provon disponimin e ligjshëm të tij, të vlefshëm për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.

Argumentimi: *Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) karrotrec, të gatshëm për ofrimin e shërbimit 24 orë, është vendosur në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 40, pika 4, shkronja “ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.*

Nëpërmjet këtij kriteri, autoriteti kontraktor synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon mjetet dhe kapacitetin teknik të nevojshëm për të garantuar ndërhyrje të shpejtë dhe transportimin e automjeteve në rast defekti, avarie ose pamundësie lëvizjeje, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet drejtpërdrejt me funksionalitetin dhe vënien në dispozicion të automjeteve, disponimi i një karrotreci është i domosdoshëm për sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit, shmangien e ndërprerjeve dhe garantimin e ekzekutimit korrekt të kontratës. Kjo kërkesë është në përpjesëtim me natyrën dhe

përmasat e kontratës, e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për konkurrencën.

Për përmbushjen e kriterëve të mësipërme 2.3.7 dhe 2.3.7, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e ambientit/servisit dhe të karrotrecit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DT. Ndërsa dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqiten nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit sipas përcaktimeve të nenit 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar

Shënim: Kontrata e qirasë ose e huapërdorjes, nëse paraqitet si dokument provues, duhet të jetë e vlefshme për periudhën e zbatimit të kontratës dhe të lidhura para noterit.

Në rastin kur operatori ekonomik mbështetet në kapacitete të subjekteve të tjera, në marrëveshje bashkëpunimi dhe/ose nënkontraktimi, duhet të paraqitet dokumentacioni përkatës sipas legjislacionit të prokurimit publik.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OSHIS sha, të hartuara nga grupi e punës i caktuar nga titullari e AK, bazuar në nevojat e të cilës, Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit sh.a kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 845, datë 30.12.2025 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” Sha (Oshis Sh.a.) për ofrimin e shërbimeve të integruara të procesit të sterilizimit”.

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit, në përputhje me nenin 36 të ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë pjesë e pandarë e DST.

NJËSIA E PROKURIMIT